



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 666 Prot.

Tiranë, më 07.04 . 2026

V E N D I M

Nr. 75 , datë 07 .04. 2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën nr.222 regj, datë 06.10.2025, paraqitur nga ankuesja znj. B.Ll kundër Spitalit Rajonal Elbasan, në të cilën pretendon se është diskriminuar për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese parashtron:

“Jam lindur dhe rritur në Elbasan. Prindërit e mi ishin punonjës të Spitalit Elbasan në atë kohë. Pak më shumë se një muajsh (41 ditësh) kam qenë shpesh pjesë e ambienteve të spitalit, e Repartit Distrofik në atë kohë pasi mamaja ime punonte aty dhe më merrte me vete (nënat dilnin në punë 40 ditë pasi lindnin). Pra lidhjet e mia me Spitalin e Elbasanit janë shumë të hershme. Pas vitit të parë të shkollës së mesme në moshën 16 vjeç u punësova në këtë spital si sanitare, ishte viti 1990. Kam vazhduar studimet, shkollën e mesme të përgjithshme, pa shkëputje nga puna. Më pas ndoqa studimet për mësuesi në Universitetin Aleksandër Xhuvani, dega cikli i ulët. Pas ciklit të ulët ndoqa kursin I vjeçar “Ndihmës Infermiere Mami”. Në vitin 2001 fillova studimet në Infermieri të Përgjithshme në U.A Xhuvani, Elbasan. Gjatë periudhës së studimeve në universitet për mësuesi dhe deri në përfundim të studimeve të infermierisë kam punuar vetëm turni i tretë (rreth 9 vite). Stresi dhe lodhja,

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

²Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

mbi të gjitha ankthi për vajzat e mia të vogla, të cilat i lija natën vetëm në shtëpi kur shkoja në punë turni i tretë (bashkëshorti ishte në emigracion) shkaktuan një humbje peshe të trupit tim rreth 25 kg.

Në vitin 2006, kalova infermiere Spitalin Xh. Kongoli, ku për afër 18 vite kisha punuar si sanitare, afro 9 vite vetëm turni i tretë, pasi gjatë ditës shkoja në shkollë. Më vonë u propozova kryeinfermiere nga drejtoria e spitalit në pediatri, por pranova të punoja si infermiere në shërbimin e Poliklinikës së Specialiteteve, pasi spitali ishte rreth 1 orë larg nga shtëpia ime, ndërsa Poliklinika është rreth 7 minuta. Kam punuar me disa mjekë të ekografisë në Poliklinikë. Prej 5-6 vitesh punova me mjekun e përgjithshëm K.D, i cili u transferua nga Belshi në Elbasan si mjek specialist pas një trajnimit disa javor në Tiranë për EKO dhe Skaner. Së fundi ky mjek i përgjithshëm është pozicionuar Shef i kabinetit të Radiologjisë. Puna me këtë mjek ka qenë disi e sikletshme në disa situata, pasi konfidencialisht bënte disa pyetje të cilat më vinin në vështirësi dhe siklet si psh: “sa të vajtj rroga ty Blerta?”....po Kelit (bashkëshorti) sa ia kanë rritur rrogën aty ku punon?..... sa e kanë qiranë e konviktit vajzat...(vajzat janë studente në Fakultetin e Mjekësisë në Maqedoni në vitin e gjashtë)? Sa herë vijnë në Shqipëri vajzat?”

Ai nuk pyeste kot. Edhe unë mund ta pyesja për shpenzimet e fëmijëve të tij në shkollat private më të shtrenjta në vend, për shtëpinë në Tiranë, Belsh Elbasan, për makinat. Duke njohur tipin e tij që bëhej xheloz për këdo që kishte sukses në jetë apo karrierë, kuptoja se ai ndiente xhelozia për realizimin e studimeve të fëmijëve të mi në një degë ku ai ka vetëm një nga katër fëmijët tek Zonja e Këshillit të Mirë. Indirekt llogariste financat e mia, duke dalë në një përfundim se si arrija unë ti mbaja vajzat studente, me të ardhurat e mia. Gjithashtu mendoj se edhe udhëtimet e mia jashtë Shqipërisë i llogariste.

Së pari vajzat janë të martuara prej vitesh dhe bashkëshortët janë në punë që financojnë shkollën. Njëra është martuar me shtetas britanik, tjetra është martuar me një djalë i cili ka ndjekur shkollën e mesme në New York dhe të lartën në Moskë ku është diplomuar. Kanë të ardhura shumë herë më të mëdha se unë. Nuk kam unë kapacitetin e të ardhurave për ti ndihmuar vajzat me shpenzimet e shkollës.

Së dyti, shpenzimet e udhëtimeve kanë qenë pjesë e shpenzimeve, e dëshirës dhe kënaqësisë së të afërmeve të mi, të miqve, të krushqive.

Ky mjek mbase i ka kishte përfunduar llogaritë e veta dhe bënte të miat, i ushqyer nga xhelozia për arritjet e mia deri diku, xheloz bëhej për respektin e shumë njerëzve ndaj meje gjatë vizitave që bënin në Poliklinikë tek Ekoja. Kjo patologji e këtij njeriu është manifestuar edhe në shumë raste të tjera. Unë nuk bëhem xheloze për të që ka dy-tre shtëpi, që ka ndjekur fëmijët në shkolla të shtrenjta, që ka dy-tre makina. Dyshoj se është ky njëri, që ka nxitur drejtorin të më transferonte në Poliklinikë drejt një pavioni në ambientet e spitalit duke ma vështirësuar jetën dhe mundësinë e kujdesit ndaj nipit të cilin ma kanë lënë prindërit në ngarkim, gjë që do sillte ndalimin e studimeve të vajzës nëse do kthehej për të mbajtur djalin.

Arsyet e transferimit tim ishin personale të drejtuesve të spitalit aspak në përmirësim të punës apo shëndetit të pacientëve. Nuk e rrit cilësinë e punës një infermiere që ka probleme me shëndetin. më detyruan të punoj (vetëm mua nga lista e infermierëve që kishin caktuar të punonin në atë repart) në

terapi tek të sëmurët me kancer, ndërkohë që kisha probleme të rënda alergjie në këtë ambient, që kisha dhe kam një fëmijë të vogël në ngarkim (rreth pesë vjeç) në përkujdesje, me probleme komunikimi. Një infermiere më të re se unë E. Daja që punonte në Poliklinikë (rreth 40 vjeçe) me kualifikime më pak se unë, e emëruan kryeinfermiere në maternitet me ngritje në detyrë, në të njëjtën kohë që mua më detyronin të bëja terapi tek të sëmurët me kancer edhe pse sytë më kruheshin, trupi më bëhej pulla-pulla nga alergjia... frymëmarrja më dobësohej, kisha kruarje te trupi, rëndesë të kokës. Pasoja ndikonin në pagën time, pasi më duhej të blija ilaçet, por mbi të gjitha tek djali i vajzës (të cilin ma lanë prindërit në ngarkim për përkujdesje), po shkon 5 vjeç nuk ka folur asnjë herë deri tani. Së bashku me bashkëshortin e saj na e besuan në gjyshërve përkujdesjen ndaj vogëlushit, pasi është studente në Maqedoni për të realizuar premtimin që i bëri gjyshit të saj para se të ndërronte jetë (babai im). Do bëhej doktoreshë. U detyrua ta ndiqte në Maqedoni pasi fitoi konkursin atje dhe meqë Fakulteti i Mjekësisë së Tiranës nuk pranonte studente që kishin mbaruar një degë më parë në U. Tiranës. Mjekësinë e ka degë të dytë, pasi është diplomuar më parë në U. Tiranës Drejtësi.

Djalë e vajzë e kemi në kujdestari të plotë në moshën 3 muaj e gjysmë, periudhë të cilën vajza u largua në Maqedoni për të vazhduar Universitetin. Në këtë moshë, i filluam ushqim artificial. Problemet e vogëlushit me komunikimin i kemi kuptuar më parë, por duke mos pranuar realitetin, kemi shpresuar që do përmirësohet. E kemi ndjekur me kontrolle për ta konfirmuar me specialiste dhe përfundimisht dolëm në një konkluzion që vogëlushi ka mungesë të vëmendjes, komunikimit.

Aktualisht po e ndjekim me logoped. Është shumë e vështirë përkujdesja e një fëmije të tillë, pasi nuk e kuptojmë shumë herë se çfarë e shqetëson. Vogëlushi ka probleme me alergjinë, aneminë dhe mungesën e imunitetit. Disa herë kemi shtruar urgjent në spital pasi problemet pulmonare i shkaktojnë ulje të oksigjenit dhe jemi të detyruar ta trajtojmë me oksigjen-terapi dhe mjekime plotësuese në spital.

Kam dërguar ankesa pa pushim në institucionet shtetërore për transferimin e padrejtë që mu bë nga Poliklinika në Paliativ nga drejtuesit e Spitalit Elbasan, të cilët e dinin që kujdesesha për një fëmijë. “Ia do qejfi dhe e mban, le ta mbajë e mase ajo e ka pjellë”, shpreheshin indirekt. Nuk po kujdesesha për një të huaj, për të cilin nuk kisha fare përgjegjësi. Po kujdesem akoma për gjakun tim. Bota sot kujdeset për qen e mace që i gjejnë në rrugë dhe i marrin në shtëpi, ndërsa ndaj meje shpreheshin sikur foshnja ishte një objekt pa shpirt. Tmerr.

Edhe mjeku ku punoja K.D ma shprehte drejtpërdrejtë mendimin e tij kur i kërkoja leje për ta çuar vogëlushin në spital “le ta mbajë e ëma o Blerta se nuk është fëmija jot” “ta lëri shkollën, jepja ta mbajë fëmijën e vet” Edhe vajza e vuan largësinë ndaj fëmijës dhe problemin që ai ka në komunikim.

Ligjërish mua më takonte të kisha benefite nga drejtoria e spitalit në ndihmë të të voglit. Kjo drejtori përkundrazi më shkatërroi shëndetin duke mos marrë asnjë masë për largimin nga vendi i punës ku kisha probleme shëndetësore. I vajta në zyrë shefit të burimeve njerëzore me shenja të dukshme alergjie që ta shikonte drejtpërdrejtë situatën time shëndetësore të rënduar, por pas një fraze time sapo hyra në zyrë “tu marrka fryma nga era e duhanit këtu, pse nuk dilni aty te ballkoni ta pini se këtu asfiksohesh” juristja që punon në ambientet e asaj zyre N.T dhe që po pinte cigare e papërmbytur dhe me arrogancë më urdhëroi ndër të tjera të largohesha nga zyra e saj, pas një

debati të krijuar. Për këtë juriste ka edhe një ankesë në M.Sh nga një grup infermierësh për të njëjtin problem; duhan pirjen e theksuar në ambientet e zyrës.

Për problemin tim me alergjinë kam vënë në dijeni disa herë drejtuesit e spitalit, por nga ana e tyre nuk u mor asnjë masë.

Ankesat e mia nëpër institucionet e M.SH, KLSH nervozuan në ekstrem drejtuesit e spitalit Elbasan (edhe në një letër të drejtorit të spitalit është cituar ky fenomen i ankesave të mia). Ato kërkonin të hakmerreshin, të më hiqnin nga puna në çastin e parë që do u krijohej mundësia. Përveç kësaj urrejtja ndaj meje e drejtuesve të spitalit ishte aq e madhe sa që nuk u dukej gjë e madhe largimi im nga puna, por kërkonin të më fusnin në burg (konfidencialisht më njoftuan dashamirës disa javë para pushimit tim nga puna për këtë gjë) Më porositën të bëja kujdes në punë sepse drejtori ishte betuar se do më fuste në burg me një gabim timin sado të vogël. Nuk e besova personin që ma tha, por vonë u konfirmua urrejtja e tij. Padia që Drejtoria e Spitalit kishte bërë ndaj meje në Prokurorinë e Elbasanit e konfirmoi, padia e cila u pushua brenda 24 orëve nga prokurorja e çështjes.

Çashti më i volitshëm për ta (Drejtorinë e Elbasanit) ishte dalja e një shoqëruesi pacienti (në Portalin JOQ), i cili ngjiste shkallët me një karrocë në krahë në shkallët e spitalit të Elbasanit. Mendoj se ky njëri ka qenë i implikuar nga drejtoria në skenarin që kjo drejtori kishte bërë, në të cilën më përfshinë pjesërisht dhe më bënë me faj totalisht. Brenda 48 orëve u pushova nga puna direkt dhe u padita në Prokurori sikur të kisha bërë krim. Pa asnjë paralajmërim, pa sqaruar situatën. Ata kanë kamerat të cilat nuk i hapin me zë, sepse nëse do të dëgjohej zëri i asaj dite që shoqëruesi mbante karrocën, atyre u zbulohet skenari ndaj meje. Në ankesat e tyre nuk ka asnjë konkrete ligjërish. Ankohen në përgjithësi, pa detaje ndaj meje. Sigurisht gjykata do vërtetojë shumë shkëlqe me dokumentacionet e tyre për të cilat do mbajnë përgjegjësi.

Kam një referencë shumë të mirë nga drejtori i spitalit 5 ditë parë transferimit. Çuditërisht pas kësaj reference dhe pasi më detyruan të punoj në Paliativ u bëra problematike në drejtori. Duket qartazi që e morën personale sepse pas transferimit u ankova për ta në institucione të ndryshme.

Drejtuesit e Spitalit janë manipulues sepse më kërkuan raport-mjeko-ligjor për paaftësi në punë. Ky raport paaftësie më hiqte direkt nga puna pa i lodhur ata, pasi një nga pikat e kontratës do të shkelej nëse do të paraqisja këtë raport. Janë gënjeshtarë, sepse nuk u ngrit asnjë komision për transferimin tim. Nuk ka asnjë dokument konkret me emra të komisionit për transferimin tim. Pra ky dokument i firmosur nga komisioni nuk ekziston, gjë që vërteton skenarin e rëndomtë të drejtuesve të spitalit ndaj një punonjëse të thjeshtë.

Gënjyen pranë zyrës së ndihmës juridike Elbasan, kur thanë se çështja ime ndiqet nga prokuroria e Elbasanit. Ata e dinë shumë mirë që çështja është mbyllur brenda 24 orëve.

Gënjyen kur thanë se KLSH i mbështet. Ndërkohë nga KLSH nuk ka asnjë dokument. Drejtoria e Spitalit ka falsifikuar dokumentin e KLSH, duke përdorur vulat e spitalit dhe jo të KLSH. Më kanë mohuar të drejtën e informimit me dokumentin që pretendohet që është nga KLSH, por pa vulë dhe pa protokoll nga institucioni.

Kjo drejtori shpif kur thotë se kam thyer etikën në punë dhe kam munguar në punë. Duhet ta përcaktojë konkretisht me data dhe me fakte. Drejtoria flet në përgjithësi, kjo nuk është bindëse nga ana e institucionit dhe ligjërishit e papranueshme në këto akuza jo korrekte.

Shpifja e drejtuesve të institucionit (spitalit) është karakteristikë në përditshmërinë e punës së tyre për të mbushur planet e skenarëve për interesa personale sikurse skenari që sajuan për transferimin tim nga Poliklinika deri në pushimin tim nga puna.

Krijuan një suprimim të vendit të punës ku punova për vite të tëra e respektuar nga të gjithë. Shpifën dhe sajuan një term qesharak vendi i punës si “infermiere e Ekos” është suprimuar, vetëm e vetëm që të përmbushnin dëshirën e mjekes kardiologe që u vizion dhe u ndjek të afërmit e tyre. Plotësuan dëshirën e kësaj mjekeje duke më zëvendësuar mua me nusen e vëllait të saj, e cila punon sot me mjekun e ekos. Profesionalisht jam e gatshme të përballem me këtë infermiere të papërgatitur, e cila pa e njohur profesionin realisht kërkon të jetë e qetë. Më e vogël se vajzat e mia, më e re për të dhënë shërbimet, më e palodhur nga jeta, kjo vajzë u punësua pas mjekut, ndërsa mua më dërgoi drejtoria të punoj në terapi në pavion edhe pse kishte detyrime ligjore të më suportonte për shkak të kujdestarisë ndaj një fëmije me probleme.

Vendi i Punës i suprimuar ndaj drejtorisë e spitalit ishte një lojë qesharake ndaj meje. Ky vend pune i suprimuar në shkresë realisht ka qenë i hapur gjatë gjithë kohës. Suprimimi ishte vetëm për mua në shenjë hakmarrje sepse u ankova.

Jam edhe unë motër e një doktori shumë herë më të respektuar se mjekja kardiologe që kërkoi vendin tim të punës për kunatën, por me një ndryshim. Pacientët që kuron vëllai im janë shtetas amerikanë, ndërsa kjo mjeke ka si pacientë të afërmit e drejtuesve të spitalit me të cilët bëri marrëveshjen e punësimit të kunatës së saj. Ky ndryshim është tregues i qartë. Infermierja që më zëvendësoi mua i kërkoi kunatës mjeke vendin tim të punës. Unë nuk e përfshiva fare vëllanë në këtë lojë në ndyrë të drejtuesve të spitalit. Çështjen e dinjitetit të cilën do ta kërkoj deri në fund me anë të drejtësisë.

Shqetësimi që më kanë shkaktuar drejtuesit e spitalit ka pasur ndikim negativ në shëndetin tim, në jetën time financiarisht dhe mbi të gjitha edhe në përkujdesjen ndaj djalit të vajzës time.

Drejtuesit e spitalit injoruan formimin tim profesional, jo vetëm duke mos marrë parasysh si kriter transferimin tim nga Poliklinika e Specialiteteve në repartin paliativ, por edhe si alternativë e një mundësie për të fituar portalin gjë e cila ndodhi brenda vitit.

Në tetor 2024 u shpalla fituese në Portalin Infermierë për Shqipërinë duke u renditur e treta në rang kombëtar. Edhe në raundin e dytë u shpalla fituese edhe pse pata debat ditën e provimit pasi më ulën pikë sy për sy. Pranova të punësohem në spital fillimisht si provizore ku prisja të kaloja definitive pas një muaji, sipas procedurave të punësimit.

Në datën 8 maj 2025 firmosa formularin e DRSH fillimisht për të punuar në spital. Po atë ditë firmosi edhe një infermiere tjetër. Ajo filloi punë ndërkohë që unë prisja të më telefononin nga spitali. Kaluan disa ditë. U interesova pranë zyrës së burimeve njerëzore të Spitali. Shefi i burimeve njerëzore më gënjente duke më mohuar punësimin tim dhe më thoshte se nuk kishte shkuar emri im.

Pasi shkova edhe disa herë edhe tek DRSHKSH dhe në spital tek zyra e burimeve njerëzore, u pranua se emri im kishte vajtur, por ai ia kishte dërguar auditit emrin tim për shqyrtim.

Kam pritur përgjigje për ditë të tëra. Më pas ju drejtova Zyrës së Ndhmës Juridike Falas në Elbasan ku punonjësi i kësaj zyre më ndihmoi në përpilimin e kërkesave ndaj kësaj pengese në institucionet përkatëse. Nuk kam marrë ende përgjigje nga DRSHKSH Tiranë dhe nga MSH. Problemi im mbetet pezull.

Çështjen e kam trajtuar që në origjinën e problematikës për të qenë më e qartë mbi pengesën që kjo drejtori bën ndaj meje për një të drejtë njerëzore bazë e jetës.

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga ana ime vërtetohen përpjekjet e drejtorisë së spitalit për të më hequr nga puna vetëm sepse u ankova për ta në institucione të ndryshme për transferimin e vendit të punës, të cilën ata e bëjnë jo për të rritur cilësinë e shërbimit por sepse kishin përfitime personale nga ky transferim.

Përgjigja e drejtorisë së spitalit për problemin tim të refuzimit për të më punësuar ka qenë zyrtare vetëm ndaj drejtorisë së ndihmës juridike falas në datë 15.07.2025, e cila justifikohet me një gënjeshtër nga ana e drejtorisë ndaj meje ka një kallëzim penal për veprën penale të shpifjes. Kjo çështje është pushuar dhe drejtuesit e spitalit e dinë shumë mirë këtë fakt. Sipas tyre punësimi im do të krijonte situatë të papranueshme ligjore-etike, por që unë jam thjesht infermiere dhe do bëj punën e infermieres. Nuk kam lënduar asnjë pacient, nuk ka pasur ankesa ndaj meje nga asnjë koleg, pacient, shoqërues pacienti gjatë 33 viteve të punës deri në momentin që u ankova ndaj drejtorisë për transferimin tim të padrejtë dhe vetëm nga kjo drejtori ka pasur akuza të pabazuara dhe të inskenuara më synimin për të më dëmtuar sa më shumë. Pra mendoj me shumë bindje se mospunësimi im në këtë spital është pasojë e hakmarrjes personale të drejtuesve të këtij institucioni.”

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri ndjekjen e çështjes deri në punësimin e saj nga Spitali Rajonal Elbasan në një vend pune pa dëmtuar shëndetin e saj, sikurse puna në Poliklinikën e Specialiteteve Elbasan, ku nuk ka medikamente që dëmtojnë shëndetin, ku punoi dhe nuk pati probleme shëndetësore.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në lidhje me bindjet politike, pretenduar nga ankuesja si shkak diskriminues, duke parashikuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën,

gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Në nenin 12/1/b, të LMD përcaktohet: *“Ndalohej diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; “*

Bazuar në nenin 5, pika 1, të LMD, ndalohej diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri vlerësoi se, ankesa e paraqitur ishte në përputhje me kërkesat e nenit 33, pikat 3 dhe 4, të LMD dhe u pranua për shqyrtim. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1208/2 prot., datë 21.10.2025, Komisioneri njoftoi subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa, Spitalin Rajonal Elbasan, për fillimin e procedurës administrative, duke kërkuar parashtrime dhe informacion në lidhje me ankesën.
2. Me shkresën nr.1613 prot., datë 07.11.2025, Spitali Rajonal Elbasan, ktheu përgjigje, duke parashtruar se:

Kontrata e punës me znj. Llace është zgjidhur në mënyrë të menjëhershme më datë 17.07.2024, në mbështetje të nenit 153 dhe 154 të Kodit të Punës, për shkelje të rënda të detyrimeve kontraktuale, etiko-profesionale dhe ligjore. Aktualisht znj.Llace ka një proces gjyqësor të hapur ndaj Spitalit Rajonal Elbasan, i regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për çështjen civile me objekt “Konstatim i zgjidhjes së kontratës së punës si të paligjshme.”

Gjithashtu, ndaj znj. Llace është depozituar një kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për konsumimin e veprës penale të “Shpifjes” sipas nenit 120 të K.Penal, si dhe për cenim të etikës së institucionit dhe të të drejtave të pacientëve. Sa i përket këtij kallëzimi prokuroria e Elbasanit ka marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal, me pretendimin se nuk ka elementë

të konsumimit të veprës penale, por ka elementë për mbajtjen e përgjegjësisë civile. Për këtë arsye, institucioni ynë ka depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan kërkesë padinë me nr.446 prot datë 11.03.2025 me objekt: *“1. Ndjekja penale e të akuzuarës B.Ll për veprën penale “Fyerje” dhe 2. Detyrimin e të akuzuarës B.Ll të shpërblejë dëmin e shkaktuar viktimës akuzuese”*.

Në përputhje me parimin e konfliktit të interesit sipas nenit 3, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2025 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, çdo angazhim i mëtejshëm i znj.Llace pranë Spitalit Rajonal Elbasan do të krijonte një situatë të papranueshme institucionale, ligjore dhe etike, që bie ndesh me misionin e kujdesit dhe besimit publik që mbart një institucion shëndetësor.

Për rrjedhojë institucioni ynë ka kërkuar që Komisioni dhe Sekretariati i Portalit “Infermierë për Shqipërinë” të mos finalizojë lidhjen e kontratës së punës së znj. B.Ll me Spitalin Rajonal Elbasan dhe të vlerësojë transferimin e saj në një vend tjetër vakant, sipas mundësive dhe nevojave të institucioneve të tjera shëndetësore, deri në përfundimin e procesit gjyqësor dhe administrativ në zhvillim.

Në vazhdimësi të korrespondencës së kthim-përgjigjeve nëpërmjet adresës zyrtare, ankuesja znj.B.Ll është informuar nga Drejtoria e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor për pretendimet mbi procesin e emërimit, e dokumentuar me *e-mailin* e datës 18 qershor 2025.

3. Me *e-mailin* e datës 28.11.2025, ankuesja ka depozituar kundërshtimet e saj në lidhje me përgjigjen e Spitalit Rajonal Elbasan, duke parashtruar:

Dokumentacioni i dërguar nga Spitali Rajonal i Elbasanit është i paplotë. Ka interpretime të ligjit të cilat nuk kanë lidhje me rastin e saj. Ka tendencë dhe qëllime nga spitali për të penguar punësimin e saj pa u bazuar në ligje konkrete. Neni 3 i ligjit 9367, dt. 74.2005 nuk ka lidhje me rastin e saj, ndërkohë është mbështetur në këtë ligj për të mos e punësuar.

Dokumenti i datës 07.11.2025, nr.prot. 1613, konfirmon se Spitali Elbasan ka zgjidhur kontratën në mënyrë të menjëhershme, pa paralajmërim. Po në këtë dokument theksohet *“shkelje të rënda të detyrimeve kontraktuale etiko-profesionale.”* Ky dokument nuk ka asnjë fakt konkret të bashkangjitur pasi nuk ekziston as edhe një shkelje e rëndë. Përkundrazi nga drejtuesi i këtij institucioni (spitalit) ka një dokument reference me vlerësim shumë të mirë të firmosur nga ish drejtori A.G. Ndaj meje nuk ka asnjë kallëzim penal aktualisht. Kallëzimet e mëparshme nga spitali janë pushuar nga Prokuroria Elbasan. Spitali duhet të mbajë përgjegjësi ligjore për këtë mashtim. I njëjti drejtues i ka dhënë vërtetim si punonjëse shumë e mirë dhe e padit në prokurori për shpifje. Një qëndrim nga ana e titullarit tendencioz dhe aspak serioz ndaj saj. Në datë 17.07.2024 padrejtësisht e pushuan nga puna. Meqënëse fitoi portalin në 2025 duhet të ishte në punë në datë 18.07.2025. Ky spital ka punësuar infermiere nga portali edhe pas datës 17 korrik ndërkohë që edhe unë duhet të isha punësuar.

4. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”*, për të

sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri vendosi zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 16.12.2025 ora 10:00. Zhvillimi i seancës dëgjimore i'u njoftua palëve me shkresën nr. 1208/4 prot., datë 09.12.2025.

Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesëmarrjen e ankueses, e cila mori pjesë personalisht dhe Spitalit Rajonal Elbasan, përfaqësuar nga E. A, me detyrë jurist, pranë Sektorit të Çështjeve Ligjore, sipas autorizimit nr.1856/1 prot datë 15.12.2025.

5. Me shkresën nr. 415 datë 24.02.2006, Komisioneri kërkoi informacion nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Qendrore dhe Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Elbasan, duke kërkuar informacionin e mëposhtëm:

- Procedurën dhe praktikën e plotë të konkurrimit të ankueses B.Ll në Portalin “Infermierë për Shqipërinë”.
- Cilat kanë qenë kriteret e punësimit për vendin e lirë të punës ku ankuesja ka konkurruar?
- A ka të drejtë institucioni shëndetësor të refuzojë lidhjen e kontratës së punës me konkurrentin e shpallur fitues, në vijim në procedurës së ndjekur në Portalin “Infermierë për Shqipërinë”? Nëse po, ku parashikohet dhe rregullohet kjo e drejtë?
- A ka praktika të tjera ku institucionet shëndetësore kanë refuzuar të lidhin kontratën e punës me kandidatin e shpallur fitues sipas Portalit “Infermierë për Shqipërinë” dhe nëse po për cilat arsye?
- A ka paraqitur znj. B.Ll ankesë në lidhje me refuzimin për të nënshkruar kontratën e punës dhe si janë trajtuar këto ankesa nga ana juaj?

Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Qendrore dhe Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Elbasan, nuk depozituan informacionin e kërkuar nga Komisioneri.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Bazuar në ankesën objekt shqyrtimi, aktet e administruara dhe parashtrimet dhe kërkimet e ankueses, Komisioneri fillimisht thekson se, objekt i kësaj ankese që është marrë në shqyrtim nga ana e tij është refuzimi për nënshkrimin e kontratës së punës me ankuesen nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan. Referuar formularit të ankesës, ankuesja ka saktësuar se diskriminimi pretenduar në ankesën objekt shqyrtimi ka ndodhur në datë 8.5.2025, moment ky që lidhet me procedurën e punësimit bazuar në Portalin “Infermierë për Shqipërinë”.

Nga aktet e administruara, rezulton se, pretendimet e ankueses, në lidhje me transferimin e saj nga Shërbimi i Poliklinikës në infermiere në Klinikën e Kujdesit Paliativ dhe Njesisë së Kemioterapisë në Shërbimin e Patologjisë, janë trajtuar nga Komisioneri në kuadër të një tjetër ankese që ankuesja

ka paraqitur pranë Komisionerit (ankesa nr.60 Regj., datë 26.03.2024) për të cilën është disponuar me vendimin nr.179, datë 05.06. 2024, në të cilin është vendosur: “*Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses B.Ll , në të drejtën për punësim, për shkak gjendjes shëndetësore dhe bindjeve politike, nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan.*”. Ndërsa, në lidhje me përfundimin e marrëdhënies së punës për pozicionin infermiere në Klinikën e Kujdesit Paliativ dhe Njesisë së Kemioterapisë, ankuesja i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në vlerësim të pretendimeve të ankueses B.Ll , e cila pretendon se refuzimi për të lidhur kontratën e punës nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan është hakmarrja për ankesat që ajo ka paraqitur në disa institucione, në lidhje me transferimin e saj, Komisioneri ka çmuar të shqyrtojë dhe analizojë kërkesën e ankueses, lidhur me pasojat e ardhura pas ankimimit të saj për diskriminim të paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kundër Spitalit Rajonal Elbasan.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezulton se, ankuesja Blerla Llaci ka filluar punë për herë të parë në Spitalin Rajonal Elbasan në vitin 1990. Më pas, me diplomimin për infermierë” në vitin 2006 është emëruar infermiere dhe deri në korrik të vitit 2023 ka ushtruar detyrën e infermieres së ECHO-s pranë Shërbimit të Poliklinikës. Në korrik 2023 në kuadër të ristrukturimit të Spitalit Rajonal Elbasan, ankuesja është transferuar nga pozicioni i infermieres në Shërbimin e Poliklinikës në pozicionin infermiere në Klinikën e Kujdesit Paliativ dhe Njesisë së Kemioterapisë në Shërbimin e Patologjisë. Në datën 17.7.2024, Spitali Rajonal Elbasan, ka vendosur të zgjidhë në mënyrë të menjëhershme kontratën e punës me ankuesen nga pozicioni infermiere në Klinikën e Kujdesit Paliativ dhe Njesisë së Kemioterapisë në Shërbimin e Patologjisë.

Nga verifikimet e kryera kryesa nga Komisioneri, në faqen zyrtare të Portalin “*Infermierë për Shqipërinë*”³, rezultoi se, në zbatim të udhëzimit Nr. 204, datë 09.04.2024 “*Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë*”, nëpërmjet platformës elektronike “Infermier për Shqipërinë” të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor ka shpallur thirrjen për konkurim për profesionistë të shkencave mjekësore teknike për profilet Infermieri, Mami, Teknik Imazherie, Teknik Laboratori, Fizioterapi dhe Logopedi për institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë, me periudhë aplikimi 22.08.2024 deri më datë 05.09.2024. Kjo shpallje është publikuar në 22.8.2024, në faqen web: <https://infermierepershqiperine.al/>.

Referuar listës emërore paraprake të kandidatëve profesionistë të shkencave mjekësore teknike që i janë përgjigjur thirrjes për aplikim për periudhën 22.8.2024-06.09.2024, publikuar në datën 03.10.2024, rezulton se ankuesja ka aplikuar për të marrë pjesë në këtë konkurim, për profilin infermier, Njësia Vendore Elbasan.

Sipas listës emërore me rezultatet përfundimtare të kandidatëve profesionistë të Shkencave Mjekësore Teknike, të cilët iu përgjigjën thirrjes për aplikim në portalin “Infermierë për Shqipërinë” në datat 22.08.2024-06.09.2024, në përfundim të fazave të konkurimit, ka rezultuar që ankuesja është

³ <https://infermierepershqiperine.al/>

kualifikuar dhe është shpallur fituese për profiling infermier, Njësia Vendore Elbasan, e renditur me numër rendor 22, me një total pikësh 69.3.

Në datën 19.2.2025, është publikuar listëprerja e aktualizuar e profesionistëve të shkencave mjekësore teknike, nga ku rezulton se, ankuesja B.LI , renditet me numër rendor 32, në profilin infermier, Njësia Vendore Elbasan, me 69.3 pikë në total.

Në listëprerjen e aktualizuar të teknikëve të shkencave mjekësore për Rajonin Elbasan, publikuar në datë 20.3.2025, ankuesja figuron e renditur në numrin rendor 27, në listën e përditësuar të publikuar në datë 10.4.2025 figuron në numrin rendor 26, në listën e përditësuar të publikuar më datë 5.5.2025 në numrin rendor 22.

Në listën emërore të profesionistëve të shkencave mjekësore teknike të punësuar, publikuar më datë 29.5.2025 për Rajonin Elbasan, ankuesja B.LI raportohet në listën e të punësuarve datë 8.5.2025, në institucionin shëndetësor Spitali Rajonal Elbasan B.LI për pozicionin Infermier (Provizor).

Ankuesja deklaron se pasi është njoftuar dhe ka nënshkruar duke pranuar të punësohet në pozicionin e punës infermiere (provizore), ka pritur të njoftohet nga Spitali Rajonal Elbasan për të nënshkruar kontratën dhe për të filluar punë, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Ankuesja deklaron se është interesuar pranë burimeve njerëzore të Spitalit, të cilët i kanë komunikuar se emrin e saj e kanë dërguar tek operatori dhe ishin në pritje.

Nga aktet e administruara, rezulton se më datë 28 maj 2025, Spitali Rajonal Elbasan i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Elbasan (DROSHKSH Elbasan) dhe Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Qendrore, me një kërkesë për moslidhjen e kontratës së punës me ankuesen, pezullimin e përkohshëm nga përzgjedhja për vendin e punës pranë Spitalit Rajonal Elbasan. Spitali Rajonal Parashtron se ankuesja nuk mund të rikthehet në marrëdhënie pune pranë këtij institucioni, pasi është zgjidhur kontrata e punës në mënyrë të menjëhershme për shkelje të rënda të detyrimeve kontraktuale, etiko-profesionale dhe ligjore dhe se aktualisht ankuesja ka një process gjyqësor të hapur ndaj Spitalit Rajonal Elbasan për zgjidhjen e kontratës së punës. Gjithashtu, ndaj ankueses është depozituar kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për veprën penale të shpifjes, sipas nenit 120 të Kodit Penal. Në përputhje me parimin e konfliktit të interesit sipas nenit 3, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, çdo angazhim i mëtejshëm i ankueses pranë Spitalit Rajonal Elbasan do të krijonte një situatë të papranueshme institucionale, ligjore dhe etike, që bie ndesh me misionin e kujdesit dhe besimit publik që mbart një institucion shtetëror.

Nëpërmjet kësaj kërkesë, Spitali Rajonal Elbasan kërkon që të vlerësohet transferimi i ankueses në një vend tjetër vakant, sipas mundësive dhe nevojave të institucioneve të tjera shëndetësore, deri në përfundimin e procesit gjyqësor dhe administrativ në zhvillim.

Ankuesja i është drejtuar me një ankesë Zyrës së Bashkëqeverisjes. Në përgjigje të kësaj ankese nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Qendrore, i është kthyer përgjigje se nuk mund të lidhet një kontratë pune me Spitalin Rajonal Elbasan pasi nuk ka kaluar afati një vjeçar i parashkrimit të masës disiplinore sipas nenit 203 të Kodit të Punës, mbi bazën e të cilit rregullohen

marrëdhëniet e punës. Rezulton nga aktet e administruara se në datën 11.3.2024 ndaj ankueses është marrë masa disiplinore “vërejtje me shkrim”, për të cilën ankuesja gjatë seancës dëgjimore deklaroi se nuk ka patur dijeni. Në vijim në përgjigjen që i është dërguar ankueses, theksohet se vendin e lirë të punës e përfiton kandidati pasardhës sipas listës, ndërsa në lidhje me punësimin pranë Spitalit Rajonal Elbasan, ankueses i lind e drejta dhe mund të konkuronte përsëri pas përfundimit të afatit një vjeçar nëpërmjet Portalit “Infermierë për Shqipërinë”, sipas udhëzimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.204 datë 9.4.2024.

Bazuar në listëprirjen e aktualizuar të teknikëve të shkencave mjekësore, publikuar në datë 23.6.2025, ankuesja figuron sërish të listë me numër rendor 20, profili infermier, Rajoni Elbasan, Njësia Vendore Elbasan.

Në vijim Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, ka shpallur thirrje të reja për konkurrim. Sipas përditësimit të fundit të listëprirjes së teknikëve të shkencave mjekësore, për Rajonin Elbasan, datë 05.03.2026, ankuesja figuron ende në listë pritje me numër rendor 37, duke mbartur me të njëjtin numër total pikësh 69.3 pikë në total.

Neni 26, i ligjit Nr. 55/2022 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” përcakton mënyrën e punësimit të personelit në strukturat spitalore. Ky nen parashikon:

- 1. Drejtoritë e spitaleve publike kanë të drejtën e lidhjes së kontratave, me kohë të plotë ose të pjesshme, me personelin mjekësor dhe jomjekësor sipas nevojave.*
- 2. Për të gjithë personelin mjekësor dhe jomjekësor, të punësuar sipas strukturës së miratuar, drejtoria e spitalit lidh kontratat e punës me kohë të plotë në zbatim të legjislacionit në fuqi për rregullimin e marrëdhënieve kontraktuale ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit.*
- 3. Për të gjithë personelin mjekësor, për nevoja të spitalit për mbulimin e shërbimit shëndetësor, drejtoria e spitalit lidh kontrata me kohë të pjesshme në zbatim të legjislacionit në fuqi për rregullimin e marrëdhënieve kontraktuale ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit.*

Në udhëzimin nr. 204, datë 9.4.2024, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në republikën e shqipërisë, nëpërmjet platformës elektronike”, parashikohet:

“Kreu I
Të përgjithshme

1. Ky udhëzim rregullon procedurat për punësimin, emërimin, transferimin, pezullimin, lirimin dhe disiplinën e profesionistëve të shkencave mjekësore teknike në institucionet e ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor publik, nëpërmjet portalit “Infermierë për Shqipërinë”

4. Marrëdhëniet e punës së profesionistëve të shkencave mjekësore teknike rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

5. Procedurat për punësimin e profesionistëve të shkencave mjekësore teknike udhëhiqen nga parimet e ligjshmërisë e të përgjegjshmërisë, si dhe nga vlerat e profesionalizmit, transparencës, meritës, barazisë dhe interesit më të lartë të shëndetit publik.

6. Shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve, si dhe emërimi në një vend të lirë pune realizohen nëpërmjet portalit “Infermierë për Shqipërinë”.

7. Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (në vazhdim DQOSHKSH) është institucioni përgjegjës për zhvillimin e procedurave të konkurrimit dhe të pranimit të profesionistëve të shkencave mjekësore teknike në një vend të lirë pune në institucionet e ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor publik dhe administron portalin “Infermierë për Shqipërinë”.

Drejtoritë rajonale të shërbimeve të kujdesit shëndetësor (në vazhdim DROSHKSH) dhe institucionet e tjera të përfshira në procedurë zhvillojnë pjesë të saj, sipas përcaktimeve të mëposhtme.

Kreu V

Procedura e zgjedhjes së vendit të punës dhe emërimi i profesionistëve të shkencave mjekësore teknike

5. Kandidati fitues që përzgjedh vendin e punës në institucionet në varësi të OSHKSH-së, merr aktin e emërimit nga DROSHKSH-ja dhe paraqitet pranë institucionit shëndetësor për të lidhur kontratën e punës. Kandidati fitues që përzgjedh vendin e punës në spitalet universitare/terciare dhe institucionet qendrore në varësi të MSHMS-së pajiset nga DROSHKSH-ja me vërtetim për përzgjedhjen e bërë, si dhe fletë të printuar nga portali për rezultatin e tij. Titullari i institucionit lidh kontratë pune pa afat me punonjësin që zë një vend të lirë pune. Periudha e provës është tre muaj.

8. Në rastin e krijimit të vendeve vakante të përkohshme (leje barrë lindjeje, pezullime etj.), pozicionet plotësohen nga kandidatët fitues në listë pritje, të cilët njoftohen sipas renditjes me pikë:

- a) Kandidati që punon si zëvendësues njoftohet sa herë krijohen vende të lira pune në NJVKSH-në përkatëse, sipas radhës së listës së pritjes, për të zgjedhur vendet vakante të krijuara;
- b) Në rast se në institucionin ku punon si zëvendësues krijohet një vend vakant, kandidati që punon si zëvendësues merr emërim pa afat;
- c) Pas përfundimit të periudhës së punësimit si zëvendësues, tekniku i shkencave mjekësore kalon në listën e pritjes, duke u renditur në përputhje me pikët që ka dhe qëndron në listë pritje për një periudhë deri në dy vjet të tjera;
- d) Eksperienca e punës si zëvendësues përlllogaritet për efekt pikëzimi.

Kreu III

Procedura e vlerësimit të kandidatëve

III/1 Kualifikimi i kandidatëve dhe konkurrimi me dosje.

1. Në fazën e parë, kandidatët e interesuar regjistrohen në portalin “Infermierë për Shqipërinë” dhe ngarkojnë/përditësojnë në portalin “Infermierë për Shqipërinë” dokumentet e kërkuara.

2. Dokumentet e aplikimit për profesionistët e shkencave mjekësore teknike, që duhet të hidhen në portal në momentin e aplikimit, janë:

a) jetëshkrimin e kandidatit (CV) (shtojca nr. 1);

b) fotokopje të letërnjoftimit (ID) – kriter i detyrueshëm për kualifikim;

c) fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë dhe gjeneralitetet e kandidatit);

d) diplomën universitare dhe listën e notave. Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (kriter i detyrueshëm për kualifikim);

e) lejen e ushtrimit të profesionit brenda afatit të vlefshmërisë (kriter i detyrueshëm për kualifikim);

f) deklaratë për vërtetësinë e dokumentacionit të ngarkuar online (shtojca nr. 2);

g) dëshmi të kualifikimeve shkencore (gradë ose titull akademik/shkencor);

h) dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja.

3. Kandidati dosja e të cilit nuk përmban dokumentet e detyrueshme, si më sipër, skualifikohet.”

Kodi i Punës

“Neni 203

Parashkrimi

1. Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet. Ky afat fillon nga data e lindjes të së drejtës. Kur e drejta bazohet në shkëlqen e një dispozite të Kodit Penal, afati i parashkrimit për veprën penale është i zbatueshëm edhe për veprën civile. Afati i parashkrimit për masën disiplinore është një vit, nga momenti i marrjes së masës disiplinore, njoftuar me shkrim punëmarrësit.”

Bazuar në Kodin e Punës që është legjislacioni mbi bazën e të cilit rregullohen marrëdhëniet e punës në çështjen në shqyrtim, nuk ka asnjë parashikim ose kushtëzim për lidhjen e kontratës së punës dhe vendosjen e marrëdhënies së punës midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, që lidhet me faktin se ndaj ankuesit ka masë disiplinore në fuqi. Referimi që bëhet nga OSHKSH tek neni 203 i Kodit të Punës është i pabazuar, pasi kjo dispozitë rregullon afatin e parashkrimit të masës disiplinore dhe jo me kritere për lidhjen e kontratës së punës.

Ligji nr. 55/2022 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimi nr. 204, datë 9.4.2024, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në republikën e shqipërisë, nëpërmjet platformës elektronike”, gjithashtu nuk kanë parashikime që ndalojnë lidhjen e një kontrate pune për shkak të masave disiplinore në kuadër të një marrëdhënie të mëparshme punësimi.

Justifikimi që ankueses i është dhënë nga OSHKSH, Drejtoria Qendore është kontradiktor me justifikimin e dhënë nga Spitali Rajonal Elbasan. Ky i fundit në parashtrimet e paraqitura gjatë shqyrtimit të ankesës ashtu edhe në *e-mail*-in datë 28.5.2025 drejtuar DROSHKSH Elbasan dhe OSHKSH Drejtoria Qendore, pretendon se lidhja e kontratës së punës me ankuesen, në kushtet kur është zgjidhur marrëdhënia e mëparshme e punësimit dhe palët janë në proces gjyqësor si dhe për shkak të kallëzimit që Spitali Rajonal Elbasan ka paraqitur kundër ankueses, përbën konflikt interesi sipas nenit 3, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, me arsyetimin se çdo angazhim i mëtejshëm i ankueses pranë Spitalit Rajonal Elbasan do të krijonte një situatë të papranueshme institucionale, ligjore dhe etike, që bie ndesh me misionin e kujdesit dhe besimit publik që mbart një institucion shtetëror.

Sipas nenit 3, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, “Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike. Bazuar në këtë rregullim ligjor, Komisioneri vlerëson se pretendimet e paraqitura nuk janë pretendime për të cilat ky ligj gjen zbatim.

Kodi i Punës, ligji nr. 55/2022 “*Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë*” dhe udhëzimi nr. 204, datë 9.4.2024, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “*Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet platformës elektronike*”, gjithashtu nuk kanë parashikime që ndalojnë lidhjen e një kontrate pune për shkak se palët janë në proces gjyqësor civil ose penal.

Ankuesja rezulton që të jetë shpallur fituese për pozicionin e punës provizor pranë Spitalit Rajonal dhe është publikuar në listat e personave të punësuar datë 8.5.2025, publikuar në Portalin “Infermierë për Shqipërinë”, në datë 29.5.2025. Efektivisht ankuesja nuk është punësuar për shkak se Spitali Rajonal Elbasan nuk ka pranuar që të lidh kontratën e punës me ankuesen.

Arsyeja që i është dhënë ankueses nga OSHKSH Drejtoria Qendore është e pabazuar në legjislacionin në fuqi që rregullon marrëdhënien konkrete të punësimit. Me të drejtë, fillimisht ankuesja është shpallur fituese për pozicionin e punës infermiere provizore në Spitalin Rajonal Elbasan, pasi punësimi i saj nuk kushtëzohet nga ekzistenca e ndonjë mase disiplinore ose procesi gjyqësor civil ose penal. Po të ishte ndryshe gjatë aplikimit konkurrentëve do t’ju kërkohej të depozitonin dokumentacion përkatës sipas të cilit ata nuk kishin masë disiplinore në fuqi apo proces gjyqësor civil ose penal.

Bazuar në ligjin nr. 55/2022 “*Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë*” dhe udhëzimi nr. 204, datë 9.4.2024, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “*Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet platformës elektronike*”, Spitali Rajonal Elbasan është përgjegjës për lidhjen e kontratës së punës me kandidatin fitues të dalë nga Portali “Infermierë për Shqipërinë”.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të disfavorshme lidhur me refuzimin për të nënshkruar kontratën e punës nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*.

Gjykata Kushtetuese⁴, ka mbajtur qëndrimin se: *“E drejta për punë, që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, përbën një të drejtë të individit në kuptimin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë e individit për të përfutur me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi. E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkuptojnë të drejtën e individit për të ushtruar çdo veprimtari të ligjshme që i sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që Kushtetuta i jep individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit ka si qëllim mbrojtjen e këtyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit. Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të pasur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar vetëm si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që neni 49 i Kushtetutës i bën të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë”*.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, *“E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”*. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë të hapur shkaqesh. Ndërkohë Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: *“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”*.

⁴ Vendimi nr. 20, datë 11.07.2006, i Gjykatës Kushtetuese.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejtë parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

“Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore”⁵, Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”⁶ dhe Karta Sociale Europiane⁷, e rishikuar.

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përliqjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009, i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr.18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se, trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁸. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, diskriminimi i drejtpërdrejtë, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm”⁹

LMD, është një ligj i cili është miratuar mbështetur dhe në zbatim të nenit 18 të Kushtetutës. Në linjë me interpretimin e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, sipas LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD përcaktohet se: “Ndalimi i

⁵ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991.

⁶ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

⁷ Ratifikuar me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002

⁸ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

⁹ Shih: *Biao kundër Danimarkës*, *Dhoma e Madhe*, datë 14.05.2016, § 89, *Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, *Dhoma e Madhe* 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.

diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.

Sipas nenit 3, pika 1, të LMD të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet: *““Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

LMD parashikon dhe jep përkufizimin e disa formave nëpërmjet të cilave shfaqet diskriminimi. Referuar nenit 3, pika 17, të LMD, përcaktohet se: *“17. “Viktimizimi” është trajtim i disfavorshëm ose pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi, që synon zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 1 të këtij ligji, lidhur me pretendimin për diskriminim të ankuesit.”*

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, pala ankuese e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin 33, pika 7/1 të LMD, ku parashikohet se : *“7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”* I njëjti rregullim në lidhje me barrën e provës, parashikohet edhe në nenin 82, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, ku përcaktohet se: *“2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”*

Në lidhje me barrën e provës në çështjet e diskriminimit, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 16 datë 12.03.2024 (V-16/24), ndër të tjera thekson se: *“....aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, në këtë rast punëdhënësit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga punëmarrësi (viktima e diskriminimit) te punëdhënësi (autori i diskriminimit) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë prima facie ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga punëdhënësi janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin*

se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk ka qenë për shkakë diskriminuese. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se barra e provës në lidhje me shkakë për diskriminim në marrëdhëniet e punës i përket fillimisht punëmarrësit, por nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te punëdhënësi.”

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹⁰

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës, në çështjet e diskriminimit është i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *praesumptio iuris tantum* dhe po kështu bazohet tek logjika e përdorur për vendosjen e lidhjes mes fakteve që tregojnë trajtim të mundshëm diskriminues dhe ekzistencës së këtij trajtimi në realitet. Barra e provës zhvendoset dhe pala kundër të cilës është paraqitur ankesa, për të vërtetuar se nuk ka patur diskriminim, duhet të rrëzojë supozimin faktik se ka patur diskriminim.

Sipas praktikës gjyqësore të vendosur nga GJEDNJ, prova, mund të rrjedhë nga bashkë ekzistenca e konkluzioneve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme ose e supozimeve të ngjashme të faktit të pakundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes së nevojshme për të arritur një përfundim të caktuar dhe, në lidhje me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura thelbësisht me specifikën e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe të drejtën e pretenduar¹¹.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është në rastin konkret ankimi për diskriminim i paraqitur pranë Komisionerit dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër, në rastin konkret Spitali Rajonal Elbasan.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standardin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Sa më sipër, Komisioneri arriti në përfundimin se ankuesja B.Ll , i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, lidhur me refuzimin për të nënshkruar kontratën e punës nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan.

¹⁰ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf, fq.232.

¹¹ GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

Në ankesën objekt shqyrtimi ankuesja pretendon se refuzimi për të lidhur kontratën e punës me të nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan, është një trajtim i padrejtë dhe pasojë negative që ka ardhur për shkak të ankesës për diskriminim që ankuesja ka paraqitur pranë Komisionerit kundër Spitali Rajonal Elbasan lidhur me çështjen e transferimit të saj në muajin korrik 2023 nga pozicioni i infermieres në Shërbimi e Poliklinikës në pozicionin infermiere në Klinikën e Kujdesit Paliativ dhe Njesisë së Kemioterapisë në Shërbimin e Patologjisë.

Nga aktet e administruara rezulton se ankuesja ka paraqitur pranë Komisionerit një ankesë kundër Spitalit Rajonal Elbasan, konkretisht ankesën nr.60 Regj., datë 26.03.2024, në të cilën ka pretenduar se është diskriminuar për shkak të gjendjes shëndetësore dhe bindjeve politike.

Marrëdhëniet e punës midis ankueses dhe Spitalit Rajonal nuk kanë vijuar normalisht. Nga aktet e administruara rezulton se ndaj ankueses është marrë në datë 11.3.2024 një masë disiplinore dhe më pas në datë 17.7.2024, nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan janë zgjidhur marrëdhëniet e punës me ankuesen në mënyrë të menjëhershme, me pretendimin se janë shkelur detyrimet kontraktuale nga ana e saj. Ankuesja e ka bërë zgjidhjen e marrëdhënies së punës objekt të shqyrtimit gjyqësor. Gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u administrua ndonjë informacion në lidhje me vendimarrjen e gjykatës.

Rezulton se, në të njëjtën ditë me zgjidhjen e marrëdhënies së punës me ankuesen Spitali Rajonal Elbasan ka paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan një kallëzim penal ndaj ankueses për kryerjen e veprës penale të “Shpifjes”, parashikuar nga neni 120 i Kodit Penal. Prokuroria ka regjistruar kallëzimin penal nr.1196, datë 19.7.2025. Me vendimin datë 20.7.2025, prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e paraqitur nga Spitali Rajonal Elbasan.

Me shkresën nr.446 prot datë 11.3.2025, Spitali Rajonal Elbasan ka paraqitur përpara Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan një kërkesë padi nëpërmjet të cilës kërkon ndjekjen penale të ankueses për veprën penale të “Fyerjes” parashikuar nga neni 119, të Kodit Penal dhe veprën penale të “Shpifjes”, parashikuar nga neni 120 i Kodit penal, si dhe detyrimin e ankueses të shpërblejë dëmin e shkaktuar viktimës akuzuese Spitalit Rajonal Elbasan, sipas dispozitave 608 e vijues dhe 625 e vijues të Kodit Civil.

Në analizë të sa më sipër Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit të ankueses nga Spitali Rajonal Elbasan dhe si pasojë barra e provës bie tek ky subjekt. Në këto kushte, Spitali Rajonal Elbasan, ka barrën e provës që të provojë se ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në lidhje me trajtimin e padrejtë dhe të disfavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja, në mënyrë që rrëzojë pretendimet e ankueses se këto veprime janë kryer për shkak të paraqitjes së ankesës për diskriminim pranë Komisionerit.

Spitali Rajonal Elbasan, nuk arriti të provojë se, trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja, nuk ka lidhje shkakësore me paraqitjen e ankesës për diskriminim pranë Komisionerit, ndërsa justifikimet e paraqitura në lidhje me refuzimin për të lidhur kontratën e punës me ankuesen, rezultuan plotësisht të pabazuara. Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm lidhur me veprimet e Spitalit Rajonal Elbasan, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin

e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i është nënshtruar ankuesja, mbetet ankesa për diskriminim e paraqitur para Komisionerit.

Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja B.Ll është diskriminuar nga ana e Spitalit Rajonal, duke u viktimizuar, si pasojë e paraqitjes pranë Komisionerit të ankesës për shkelje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit. Për rrjedhojë Spitali Rajonal Elbasan, ka shkelur ndalimin e diskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 3, pikat 1 e 17, nenit 5, pika 1 dhe nenit 12, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri marrjen e masave që të mundësohet punësimi i saj në Spitalin Rajonal Elbasan në një vend pune të përshtatshëm.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre*”, ndërsa në nenin 33, pika 12, përcaktohet se : “*Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës*”

Ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, në nenin 33/10, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit. Ky ligj, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 e 33 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, të ankuses B.Ll nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan, si pasojë e paraqitjes së ankesës për shkelje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Në referim të pikës 1 të Vendimit, Spitali Rajonal Elbasan, në bashkëpunim me Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Qendrore dhe Drejtorinë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Elbasan për të rivendosur në vend të drejtën e ankuses, duke e punësuar në një pozicion të ngjashëm pune me pozicionin për të cilin i është refuzuar lidhja e kontratës së punës.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Spitali Rajonal Elbasan, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Qendrore dhe Drejtoria Rajonale e

Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Elbasan, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Ankesa për diskriminim paraqitur pranë KMD

Fusha: Punësim

Lloji i vendimit: Diskriminim_Viktimizim